1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga
Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik
“.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën
përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë
personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e
prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti
Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e
prokurimit me objekt _____, është i pamiruar dhe
pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara
nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: Shërbimet që kërkohen që kërkohen: Per hartimin e planit te mbareshtimit te ekonomise pjore kullosore, Bashkia Selenice

Afatet e ekzekutimit: 12 Muaj nga nenshkrimi i kontrates, referuar termave te references

FAZAT E HARTIMIT TE PLANIT TE MBARESHTIMIT

[illegible]

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Per hartimin e planit te mbareshtimit te ekonomise pyjore kullimore, Bashkia Selenice

Detyrat: Bashkelidhur termat e refernces

Objektivat specifikë të Planit të Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, duhet të jenë:

- Përcaktimii përdorimit të territorit në përputhje me gjendjen aktuale dhe nevojat.
- Optimizimii formës së qeverisjes në përputhje me nevojat lokale, mundësitë e grumbullit pyjor dhe mjedisit për të përmirësuar prodhimtarinë.
- Optimizimi i funksioneve ndërmjet nevojave dhe mundësive ekologjike/silvikulturale në përputhje me rëndësinë multifunksionale, sociale dhe mjedisore të pyjeve.
- Përmirësimi dhe mirëmbajtja në një gjendje të mirë funksionale të grumbujve pyjor.
- Rritja e prodhimtarisë së pyjeve me funksion prodhues.
- Përmirësimi i cilësisë dhe gjendjes së grumbujve të trungishteve me funksion prodhues.
- Nxitja dhe përdorimi i ripërtëritjes natyrore sa më shumë që të jetë e mundur me qëllim që të krijohen ekosisteme pyjore që i përshtaten mjedisit.
- Pakësimi i impakteve negative në gjendjen fitosanitare të pyjeve dhe prerjeve të paligjshme.
- Rehabilitimi dhe garantimi i rritjes së qëndrueshmë të prodhimtarisë në sipërfaqet pyjore/kullimore.
- Sigurimi i pjesëmarrjes së gjërë të aktoreve lokale në marjen e vendimit për menaxhimin e pyjeve/kullotave.
- Përmirësimi i menaxhimit të pyjeve duke lidhur resurset pyjore/kullimore me interesat e përdoruesve.
- Menaxhimi i punës për hartimin e planit dhe futjen e të dhënave në SISP

Qëllimi i hartimit të Planit të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave

Hartimi i PMPK duhet të bëhet bazuar në parimin e mbarështimit të qëndrueshëm që nënkupton "të ruajë dhe të forcojë gjendjen shëndetsore të ekosistemeve pyjore për një afat kohe të gjatë dhe në të njëjtën kohë për të siguruar mundësi ekologjike, sociale, ekonomike dhe kulturore për mirëqenien e brezave aktuale dhe atyre të ardhshëm". Ky plan hartohet për ekonominë pyjore që është pjesë e e teritorit administrativ të Bashkisë Selenice dhe natyrisht në kordinim edhe me njësitë e tjera administrative fqinje apo zonat e mbrojtura nëse është e nevojshme.

Hartimi i Planit të Mbarështimit është një mjet për të njohur gjendjen aktuale të territorit, siguron një ndëveprim me aktoret dhe Bashkinë si dhe kordinim me institucionet qëndrore nëpërmjet përdorimit të SISP dhe kjo duhet të ndodhë gjatë hartimit të PMPK dhe gjatë drejtimit të ndërhyrjeve dhe ngjarjeve në periudhën e vlefshmërisë së planit.

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentim: Kriteri (1- a) është vendosur në bazë të nenit 83 të LPP dhe nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kriteri (1-b) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare 2022,2023,2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30 % i vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 shkronja c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar . Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosja e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të tre viteve të fundit 2022, 2023, 2024 të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivit . Shenim: Ne respektojmë VKM nr. 285, datë 19.05.2021” Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 4, e ndryshuar, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëqë dy bilanci të njëpasnjëshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur në zbatim të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021” Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285 datë 05.03.2009 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar , si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Ligjin nr.10091”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.i cili parashikon se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i ka shlyer detyrimet e taksave dhe të tarifave vendore për do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, e LPP, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Vendosja e kërkesës për detyrimet vendore është bërë në mbështetje të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë

pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë dy viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

ose

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 "Kërkesat për kualifikim", të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar pika 4.. *ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të pershtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të pershtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën si dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në masën 20% të fondit limit.

2.3.2 Licenca profesionale lidhur me shërbimet objekt i kontratës:

Operatori ekonomik/ofertuesi duhet të paraqesë licence në kategorinë III.7, “Shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me burimet mjedisore bazë. Referuar VKM nr 805, date 20.12.2021” Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009, të këshillit të ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 4, germa (a) e nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në VKM-ne Nr.538, date 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullave të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar.

2.3.3 Mbështetur në kërkesat të “Manuali i planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave”, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019, të germës A1 “Kontrolli i disponibilitetit dhe aftësive profesionale të stafit teknik” dhe të germës D.1.1 “Perberja e ekipit të punës”. Operatori ekonomik duhet të ketë një staf pune të kualifikuar (Inxhinier Pyjesh) për hartimin e planit të mbarështimit, me eksperiencë në fushat respektive të pyjeve dhe kullotave në hartimin e planeve të mbarështimit, të kadastrës, manualeve dhe metodikave, të certifikuar dhe licencuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, me këtë përbërje.

Stafi kryesor i kontraktorit do të ketë në përbërje minimalisht 4 (katër) specialistë, nga të këto 3 duhet të jenë pa tjetër inxhinier pyjesh dhe 1 inxhinier gjeodet si më poshtë:

- 1) Drejtuesi teknik inxhinier pyjesh (për të realizuar një planifikim shumë – funksional, për hartimin e metodikës, organizimin e stafit, planin e veprimit, grafikun e realizimit punimeve, mbrojtjen e studimit, si drejtues i grupit të punës)
- 2) 2 (dy) inxhinier pyjesh me përvojë në fushën e pyjeve/kullotave që duhet të angazhohen në grupin e punës, si në terren dhe në punimet e zyrës.
- 3) minimumi 1 (një) ekspert (Inxhinier Gjeodet) për përgatitjen e hartave dhe menaxhimin e të dhënave dixhitale GIS.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në kërkesat e germës A1 “Kontrolli i disponibilitetit dhe aftësive profesionale të stafit teknik” dhe germës D.1.1 “Perberja e ekipit të punës”, të “Manuali i planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave”, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019, të pikës 4 të nenit 77 të Lgjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në pikën 4 të germës (c) e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërket që operatorët ekonomikë të deshmojnë që kanë “fuqinë punetore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit”, që kanë në dispozicion apo që mund të vihet.

2.3.4 Stafi teknik kryesor i kontraktorit, bazuar në kompleksitetin e kryerjes së shërbimit, eksperiencën e punës dhe profilet e specialistëve duhet të shoqërohen nga ana e operatorit ekonomik me kontratat individuale të punës (OE duhet të paraqes Deklaratën e nënshkruar, ku të deklarohet se me këtë staf teknik të paraqitur për konkurrim në këtë procedurë konkurrimi, nuk kam konkurruar me parë në procedurë të ngjashme dhe nuk kam fituar dhe lidhur kontrata të tjera të

ngjashme hartim plani mbarështimi me Autoriteti/Enti Kontraktor gjatë kohës së kryerjes së këtij studimi.), rëndësinë dhe aftësitë profesionale, duhet të ketë në përbërje specialist me kualifikimin e domosdoshëm për hartimin e planit të mbarështimit si më poshtë:

a) Drejtuesi teknik duhet të jetë **Inxhinjeri pyjesh** i pajisur me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve e kullotave, për veprimtaritë e fushës së ekspertizës profesionale, të parashikuara në shkronjat, “a”, “b”, “c” dhe “ç”, sipas përcaktimeve të akteve nënligjore që rrjedhin në zbatim të pikës 5 të nenit 19 të ligjit nr. 57/2020 “Për Pyjet”, të pikes (2) të nenit 25 të Ligjit Nr.9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar, të Vendimit Nr. 284, datë 29.4.2022 “Për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve dhe kullotave”, të lëshuar nga Ministria që mbulon pyjet dhe kullotat.

Kontraktori duhet të paraqes dokumentacionin vërtetues të mëposhtëm:

- Kontratën e punës e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë e Studimeve Universitare e Fakultetit të Pyjeve. (Shkencave Pyjore)
- **“Certifikatën”**, si ekspert në fushën e pyjeve dhe të kullotave.
- Certifikatën e kualifikimit mbi “Metodat e Reja të hartimit të planeve të mbarështrimit të pyjeve”.
- CV. Jetëshkrim mbi aktivitetin profesional.
- Certifikata, referenca mbi veprimtarinë e kryer në fushën e pyjeve dhe kullotave, si dhe për hartimin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, të lëshuara nga Institucionet përkatëse të Pyjeve.

b) Kandidati ofertues duhet të ketë pjese të stafit **Inxhinier Pyjesh**, i pajisur me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve e kullotave për veprimtaritë e fushës së ekspertizës profesionale, të parashikuara në shkronjat, “a”, “b”, “c” dhe “ç”, sipas përcaktimeve të akteve nënligjore që rrjedhin në zbatim të pikës 5 të nenit 19 të ligjit nr. 57/2020 “Për Pyjet”, të pikes (2) të nenit 25 të Ligjit Nr.9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar, të Vendimit Nr. 284, datë 29.4.2022 “Për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve dhe kullotave”, të lëshuar nga Ministria që mbulon pyjet dhe kullotat.

Kontraktori duhet të paraqes dokumentacionin vërtetues të mëposhtëm:

- Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë e Studimeve Universitare Fakultetit të Pyjeve. (Shkencave Pyjore)
- **“Certifikatën”**, si ekspert në fushën e pyjeve dhe të kullotave.
- CV. Jetëshkrim mbi aktivitetin profesional.
- Certifikata, referenca mbi veprimtarinë e kryer në fushën e pyjeve dhe kullotave si dhe për hartimin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, të lëshuara nga Institucionet përkatëse të Pyjeve

c) Kandidati ofertues duhet të ketë pjese të stafit 1 (një) **Inxhinier Gjeodet**, i licencuar, (i pajisur me licencë profesionale individuale "Projektues Gjeodet", **Kategoria 8-c dhe 8.e**, sipas lidhjes 2 të VKM Nr. 759, datë 12.11.2014 "Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit dhe projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", i ndryshuar,

lëshuar nga Institucionet e autorizuar për lëshimin e licencave). Të vertetuar me paraqitjen e dokumentacionit të mëposhtëm:

- Kontratë pune e vlefshme
- Diplomë e Studimeve Universitare e Inxhinierit Gjeodet
- Licensen perkatese te lëshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise kategoria 8, a,b,c,d,e. kryesisht kategoria 8-c Sisteme GIS, si dhe të kategorisë 8-e projektim fotogrametrik dhe hartografi
- CV, Jetëshkrim mbi aktivitetin profesional.

Kriteri 2.3.4 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës të Vetë deklarimit, si dhe te shoqëruar me dokumentacionin përkatës provues. Gjithashtu OE duhet te paraqes Deklaratën e nënshkruar, ku te deklarohet se me këtë staf teknik te paraqitur për konkurrim ne këtë procedure konkurrimi, nuk kam konkurruar me pare ne procedure te ngjashme dhe nuk kam fituar dhe lidhur kontrata te tjera te ngjashme hartim plani mbarështimi me Autoriteti/Enti Kontraktor gjatë kohës së kryerjes së këtij studimi.

Argumenti: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në "Manualin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave", të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019 "Kontrolli i disponibilitetit dhe aftësive profesionale të stafit teknik", si dhe në bazë të pikës 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenit 41, pika 4 germa b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë stafin teknik të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin provues si më poshtë vijon:

- a) një listë të personelit kryesor të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj,
- b) kopje të Diplomave Studimeve Universitare, Certifikata dhe Licence profesionale, kur ka të tilla sipas legjislacionit në fuqi, CV jetëshkrime të veprimtarisë profesionale, si dhe çdo kualifikim tjetër profesional, letër motivi mbi studimet e kryera në hartimin e planeve të mbarështimit, Licenca,
- c) eksperiencia e punës dhe profilet e specialistëve duhet të vërtetohen nga ana e operatorit ekonomik me kontratat individuale të punës (të vlefshme gjatë kohës së hartimit të planit te mbarështimit).

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa për staf është e nevojshme për të garantuar Autoritetin Kontraktor se OE disponon kapacitetet me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen.

Numri i përcaktuar për secilin specialist është përlllogaritur, duke marrë në konsideratë proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës dhe është në përpjesëtim me natyrën, përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe limitet kohore të parashikuara për të përfunduar këtë kontratë.

2.3.5 Përveç stafit teknik kryesor, konsulenti duhet te paraqes një staf ndihmës si me poshtë:

Kandidati ofertues duhet të kete pjese te stafit 1 (një) Biolog. Të vërtetuar me paraqitjen e dokumentacionit të mëposhtëm:

- Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë e Studimeve Universitare..
- Niveli profesional në grada dhe tituj shkencor në lidhje me fushën është plus në kualifikim.
- CV, Jetëshkrim mbi aktivitetin profesinal.

Kandidati ofertues duhet të kete pjese te stafit 1 (një) Agronom. Të vërtetuar me paraqitjen e dokumentacionit të mëposhtëm:

- Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë e Studimeve Universitare në Degën e Studimeve Agronomi (Pedolog).
- Niveli profesional në grada dhe tituj shkencor në lidhje me fushën është plus në kualifikim.
- CV, Jetëshkrim mbi aktivitetin profesinal.

Të gjithë anëtarët e grupit të punës, do të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të hollësishme duke u mbështetur në “Manuali i Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave”, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019.

Argumenti: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ”Manualin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave”, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019 ”Kontrolli i disponibilitetit dhe aftësive profesionale të stafit teknik”, si dhe në bazë të pikës 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 41, pika 4 germa b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë stafin teknik të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Inxhinieri i pyjeve si ekspert i studimeve specifike ne bashkëpunim me Biologun mbështetur ne kërkesat e germave E.5.6 Biodiversitetin, E.5.7 Prania e vlerave konservuese te larta dhe E.5.8 Rreziqet mbi biodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin, si dhe të kërkesave të tjera të “Manuali i planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave”, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019”.

Specialistët e fushës do të vlerësojnë se Plani i Mbarështimit mbart ne vetvete edhe procesin e mbledhjes se te dhënave mbi biodiversitetin, qe do te grumbullohen nga vrojtimi ne terren gjate fazës se përshkrimit parcelar.

Te dhenat kryesore duhet te fokusohen ne:

- biotopet (Standartin 5)
- habitatet
- specie e kercenuara (Anneksin 10)
- vegjetacionin potencial (Aneksin 11)
- rezervat biogjenetike

Eshte e nevojshme qe te grumbullohen edhe te dhena nga studime te tjera dhe te integrohen ne planin e mbareshtimit si: raportet ekologjike, planet e vjetra te mbareshtimit dhe publikime te tjera (si psh:Rrjeti i Natyra 2000 per habitatet) dhe informacioni lokal. Duhet

te percaktohet nje liste me elementet ekzistues te biodiversitetit ne Ekonomine Kullosore Rrezome duke iu referuar kategorive te meparshme dhe parcelave dhe të paraqiten ato ne harten e planit. Duhet te pershkruhet rendesia dhe impakti mbi ekosistemet.

Studimin e kushteve stacionale dhe edafike. (tokën, gjeologjinë, hidrologjinë, erozionin,)

Eshte e nevojshme qe te grumbullohen edhe te dhena nga studime te tjera dhe te integrohen ne planin e mbareshtimit si: raportet pedologjike dhe informacioni lokal. Duhet te percaktohet nje liste me elementet ekzistues te tipeve dhe nentipeve te tokes, struktura dhe pjelloria e saj, elemntet kimik dhe perberja fizike ne Ekonomine Kullosore Rrezome duke iu referuar kategorive te meparshme dhe parcelave dhe të paraqiten ato ne harten e planit. Duhet te pershkruhet rendesia dhe impakti mbi token.

Të gjitha proceset e mesiperme, realizohen nga bashkëpunimi inxhinier, biolog e agronom i kontraktuar nga kandidatet ofertues.

Argumenti: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41, pika 4 germa b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë stafin teknik të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit apo që mund tu vihet.

2.3.6 Operatori Ekonomik ose bashkimi i Operatorëve Ekonomike duhet të paraqesin **Planin e punës, përqasjen teknike dhe Metodologjinë** për Hartimin e Planit të Mbarështimit (për Ekonomin/të Pyjore të ofertuar) që duhet të jetë në përputhje me Termat e Referencës dhe Manualin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019, kuadri logjik ku argumentohen objektivat, aktivitetet, aktorët, rezultatet e pritshme dhe indikatorët për realizimin me sukses të Planit të Mbarështimit. Subjekti mund të paraqesë dhe justifikojë ndonjë modifikim e përmirësim të Termave të Referencës duke përmirësuar cilësinë e kryerjes së shërbimit (Këto sugjerime duhet të jenë koncize dhe me hollësi dhe mund të përfshihen në propozim)

Plani i Punës. Në të duhet të propozohen aktivitetet kryesore për kryerjen e shërbimit, përmbajtjen e tyre dhe kohëzgjatjen, shkalla dhe raportet, kohëzgjatjen (duke përfshirë periudhën kohore të miratimit nga autoriteti i ngarkuar me ligj), dhe datat e dorëzimit të raporteve. Plani i punës së propozuar duhet të jetë konsistent me përqasjen teknike dhe metodologjinë, të tregojë mirëkuptimin e Termave te References dhe aftësine e përkthimit të tyre në një plan pune të realizueshëm. Duhet të përfshihen këtu, një listë me dokumentat përfundimtar, duke përfshire këtu edhe raportet, skicimet, dhe tabelat për tu paraqitur si outputet përfundimtare.

Metodologjia dhe Perqasja Teknike. Subjekti duhet të shpjegojë si i kupton ai objektivat e realizimit të këtij shërbimi, përqasja me shërbimet, metodologjinë për kryerjen e aktiviteteve dhe arritjen e outputeve të pritshme dhe shkallën e detajuar të këtyre outputeve. Duhet të theksojë problemet që do të adresohen dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojnë për ti adresuar ato. Gjithashtu duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adaptojë dhe të theksojë përputhshmërinë e këtyre metodologjive me perqasjet e propozuara.

(Hartuesi i planit punes dhe metodologjise nga Drejtuesi Teknik i paisur me “Çertifikatën”, si ekspert në fushën e pyjeve dhe të kullotave,

Argumenti: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 54, pika 11 germa ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të prokurimet Publik”, i ndryshuar dhe do të shërbejë gjatë fazës së dytë në vlerësimin e propozimeve teknike të dorëzuara nga operatorët ekonomikë të përcaktuar në listën e shkurtër.

